



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 5, datë 10.01.2025

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI PËR
PROKURORIN, ZONJA DOLOREZA MUSABELLIU”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*më tej, Këshilli*), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar (në mungesë)
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 10.01.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, miratuar me vendimin nr. 407, datë 17.12.2021, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Zonja Doreza Musabelliu”

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 149/a, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;
2. Neni 9 i ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
3. Nenet 164, pika 8 dhe 189, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;



Neni 8 i Rregullores "Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve".

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues Nr. 30, datë 08.01.2025, i Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit;
- ii. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, ai shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Në datë 16.12.2024, protokolluar me nr. 2698, pranë Këshillit është administruar shkresa nr. 22437 Prot./D.M., datë 13.12.2024, me lëndë "Dërgojmë kërkesën e prokurorit", e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nëpërmjet së cilës është përcjellë shkresa me lëndë "Kërkesë për veprimtari jashtë funksionit" e prokurores Doloreza Musabelliu.
3. Referuar përmbajtjes së kësaj kërkesë si dhe dokumentacionit shoqërues, znj. Musabelliu kërkon, lejimin për të ushtruar veprimtari jashtë funksionit si **eksperte për trajnimet në Projektin "Të drejtat e viktimave nuk kanë çmim", që mbështetet nga Ambasada e SHBA-ve dhe USAID.** Projekti realizohet nga Qendra Psiko-Sociale "Vatra", si një OJF që punon për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit njerëzor, viktimave të dhunës në familje e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore si dhe fëmijët e tyre.
4. Referuar kërkesës, angazhimi për këtë veprimtari jashtë funksionit përfshin:
 - Zhvillimin e 6 (gjashtë) trajnimeve në qarqet Vlorë, Fier, Tiranë, Elbasan, Berat dhe Shkodër për prokurorë dhe gjyqtarë;
 - Zhvillimin e 6 (gjashtë) trajnimeve në qarqet Dibër, Durrës, Lezhë, Korçë, Kukës dhe Gjirokastër për prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore.Trajnimet janë parashikuar të kryhen në periudhën dhjetor 2024 - maj 2025. Sipas kërkesës vlera e pagesës për kryerjen e këtyre trajnimeve nuk është përcaktuar ende.
5. Nga ana e zonjës Musabelliu është paraqitur në cilësinë e provës shkresore, vërtetimi datë 13.12.2024, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në të cilin është përshkruar ngarkesa e punës si vijon:



“Prokurorja Doreza Musabelliu, aktualisht ushtron detyrën e prokurores, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë.

Aktualisht kjo prokurore ka në hetim 32 (tridhjetë e dy) çështje penale.

Prej saj, rezulton të jenë ushtruar në kohë detyrat, me korrektësi dhe efikasitet.

Ushtrimi i rolit të ekspertit, në kuadrin e aktivitetit që zhvillohet nga Qendra e viktimave “VATRA” me temë “Të drejtat e viktimave nuk kanë çmim” mbështetur financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe USAID ... vlerësohet se nuk përbën pengesë për ushtrimin e funksionit të saj si prokurore.

Lëshohet ky vërtetim me kërkesë të të interesuarit.”

6. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkesë me qëllim saktësimin e periudhës për zhvillimin e trajnimeve të mësipërme, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit ka kërkuar nëpërmjet postës elektronike informacion plotësues nga prokurori.

Zonja Musabelliu ka informuar se, trajnimet kanë si objekt, temat që lidhen me hetimin e çështjeve penale të “Trafikimit të personave të rritur”, “Trafikimit të të miturve”, si dhe veprat penale të lidhura me to, duke pasur fokusin tek viktimat e trafikimit. Gjithashtu, prokurori ka dërguar programin dhe axhendën e trajnimit dhe datat përkatëse, si vijon:

“Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Durrës, 14 Janar 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Shkodër, 28 Janar 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Lezhë, 11 Shkurt, 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Elbasan, 25 Shkurt 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Kukës, 11 Mars 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Tiranë, 25 Mars 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Fier, 8 Prill 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Peshkopi, 22 Prill 2025, 9:00-16:00;

Trajnim me prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore Korçë, 6 Maj 2025, 9:00-16:00. “

7. Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit vlerëson se kërkesa e prokurores zonja Doreza Musabelliu, është e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.



Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

8. Nga verifikimet e kryera rezulton se, prokurorja zonja Doreza Musabelliu nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
9. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së saj.
10. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:
 - është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
 - nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohe sipas ligjit;
 - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
 - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efektive të funksioneve.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Doreza Musabelliu si eksperte për trajnimet në Projektin “Të drejtat e viktimave nuk kanë çmim”, që realizohet nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra”.
2. Ky vendim i njoftohet prokurorit Doreza Musabelliu, dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.01.2025.

KRYETAR

Mirela Bogdani

